



BULETIN JAVOR

17-21 QERSHOR 2024



PËRMBAJTJA

- Promovimi i Bashkëpunimit Rajonal në Sigurinë Kibernetike: Takimi në Kuadër të Kartës SHBA-Adriatike (A-5)
- Trajnimi i AKSK për rritjen e kapaciteteve të stafit të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit me Bashkitë dhe Mikrofinancat
- Mbahet konferenca e parë rajonale "Western Balkans Cyber Capacity Center (WB3C)" në Podgoricë
- Përfundon me sukses Webinari i radhës mbi Qeverisjen dhe Standardet e Sigurisë Kibernetike

Promovimi i Bashkëpunimit Rajonal në Sigurinë Kibernetike: Takimi në Kuadër të Kartës SHBA-Adriatike (A-5)



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, zhvilloi sot në Tiranë takimin e përbashkët të drejtuesve politikë dhe teknikë në kuadër të kryesisë së Shqipërisë këtë vit në Kartën SHBA-Adriatike (A-5).

Takimi u mbajt me pjesëmarrjen e vendeve anëtare Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, atyre vëzhgues si Kosova, Serbia si dhe Sllovenia.

Qëllimi i këtij takimi ishte forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë kibernetike në këtë grupim, si dhe promovimi i diplomacisë kibernetike.

Trajnimi i AKSK për rritjen e kapaciteteve të stafit të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit me Bashkitë dhe Mikrofinancat

AKSK, i angazhuar maksimalisht në rritjen e kapaciteteve të stafit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit si dhe institucioneve të pavarura në datat 18-19 Qershor organizoi për këtë qëllim trajnimin dy ditor me Bashkitë dhe Mikrofinancat.

Fokusi kryesor ishte njohja dhe ndërgjegjësimi i personelit të IT/CT në fushën e sigurisë kibernetike, aftësimi i tij në përgjigjen ndaj incidenteve kibernetike si dhe përgatitja e tyre në identifikimin e kërcënimeve nëpërmjet Cyber Drill (CD) – Simulime reale të incidenteve të sigurisë kibernetike.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039



17-21 QERSHOR 2024

Mbahet konferenca e parë rajonale "Western Balkans Cyber Capacity Center (WB3C)" në Podgoricë



U mbajt për herë të parë konferenca rajonale "Western Balkans Cyber Capacity Center" në Podgoricë, pranë Rektoratit të Universitetit të Malit të Zi, organizuar nga Western Balkans Cyber Capacity Centre (WB3C).

Ky aktivitet në nivel rajonal mblodhi ekspertë, politikëbërës dhe funksionarë të sigurisë kibernetike të gjithë Ballkanit Perëndimor dhe partnerët ndërkombëtarë për të diskutuar mënyrat e rritjes së qëndrueshmërisë kibernetike në rajon. Konferenca mbuloi dhe trajtoi temat kundër krimit kibernetik, sigurisë kibernetike, ndikimin e inteligjencës artificiale në sigurinë dhe diplomacinë kibernetike; u shkëmbyen pikëpamje të ndryshme, u diskutuan praktikatat më të mira në lidhje me situatat kritike me të cilat përballen vendet në zhvillim.

Të pranishëm nga Republika e Shqipërisë ishin përfaqësues të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Policia e Shtetit, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Drejtoria e Hetimeve të Krimeve Kibernetike, Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Posta Shqiptare.

AKSK përgëzon qendrën WB3C për misionin e saj për forcimin e bashkëpunimit në rajon në fushën e sigurisë kibernetike.

Përfundon me sukses Webinari i radhës mbi Qeverisjen dhe Standardet e Sigurisë Kibernetike

Më datë 20 qershor, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, zhvilloi Webinarin e radhës me temë "Qeverisja dhe standardet e sigurisë kibernetike". Më shumë se 200 pjesëmarrës, nga sektori publik dhe privat, u informuan rreth politikave të qeverisjes dhe standardeve të sigurisë kibernetike nga eksperti i Autoritetit, z.Gerald Bici.

Webinare të tilla i shërbejnë edukimit të publikut si dhe ndërgjegjësimin rreth çështjeve të rëndësishme të sigurisë kibernetike, si politikatat e qeverisjes dhe standardet e sigurisë.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen, ju mirëpresim në webinarë të tjera!

QEVERISJA DHE STANDARDET E SIGURISË KIBERNETIKE

Zbatimi në Infrastrukturën Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit
Gerald Bici



Menaxhimi i Rrezikut: Identifikimi dhe Zbatja e Kërcënimeve

Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të rrezikut për të identifikuar kërcënimet dhe dobësitë e mundshme.

Prioritizimi i rreziqeve bazuar në gjasat dhe ndikimin.

Zhvillimi i strategjive për zbutjen e rrezikut dhe zbatimi i kontrolleve.

Shembuj të Teknikave të Menaxhimit të Rrezikut në Infrastrukturën Kritike:

Modelimi i Kërcënimit

Skanimi i Cenueshmërisë

Testimi i Penetrimit



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



@aks.gov.al



+355 422 21 039